



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVO
Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash

RREGULLORE
MBI TATIMIN NË PRONË, PËR VITIN 2014

Dragash, 26.09. 2013

Në bazë të nenit 9 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.03/L-049, nenit 11 të Ligjit për Tatimin Pronën e Paluajtshme nr.03/L-204 të datës 07.10.2010 dhe Ligjit Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.04/L-100 ,nenit 12 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit ,Kuvendi I Komunës së Dragashit në seancen e mbajtur më 26.09.2013 , miraton këtë:

RREGULLORE **MBI TATIMIN NË PRONË , PËR VITIN 2014**

Dispozitat e përgjithëshme

Neni 1

1.1.Me këtë Rregullore caktohet tatimi mbi pronën e paluajtshme ,caktohen standardet dhe procedurat që duhet respektua nga ana e komunës gjatë administrimit të kësaj takse.

Neni 2

2.1. "Pronë e paluajtshme " sipas kësaj Rregullore do të thotë toka dhe ndërtesat, stabilimentet dhe godinat në sipërfaqën e tokës dhe mbi sipërfaqën e tokës dhe që janë të lidhura me tokën.Në pronën e paluajtshme përfshihen njësitë brenda ndërtesave ,siç janë banesat ose zonat për qëllime komerciale

Neni 3

3.1.Tatimi mbi pronën caktohet për tërë pronën e paluajtshme ,me përjashtim të pronës, e cila në përputhje me nenin 8 të Ligjit mbi Tatimin në Pronë është e liruar nga obligimi i pagesës së tatimit .

Neni 4

4.1. Obliguesi tatimor-tatimpaguesi është çdo person fizik apo juridik i cili është pronar i pronës së paluajtshme.

4.2. Në rastin kur pronari i pronës nuk mund të përcaktohet ose nuk mund të gjendet, tatimpagues është personi fizik ose juridik i cili e shfrytëzon ligjërisht ose mban pronën e paluajtshme.

Neni 5

5.1. Baza për llogaritjen e tatimit në pasurinë e paluajtshme do të jetë vlera e tregut e pronës.

5.2. Për çdo vit tatimor vlerë e tregut e cilësdo pronë është vlera e pronës më 31 dhjetor të vitit paraprak.

Neni 6

6.1. Tatimi mbi pronën do të grumbullohet sipas shkallëve tatimore:

1. Pronat e domosdoshme për qëllime banimi

a/ Për shtëpitë private 0,15%

b/ Për objektet banesore 0,15%

2. Pronat komerciale 0,20%

3. Pronat industriale 0,20%

Neni 7

7.1. Grumbullimi i tatimit në pronë bëhet sipas zonave tatimore dhe atë zona e parë, zona e dytë dhe zona e tretë.

7.2. Zona e parë pëfshinë qendrën komunale të Dragashit

7.3. Zona e dytë pëfshinë fshatrat

Bellobrad, Blaq, Bresanë, Brezne, Brod, Brrut, Buçe, Buzez, Gllloboqicë, Kapre, Kosavë, Krushevë, Kuk, Kukajan, Kuklibeg, Lybevisht, Mlik, Pllavë, Radeshë, Rapqë, Restelicë, Shajne, Vraniq, Zaplluxhe, Zgatar dhe Zym.

7.4. Zona e tretë pëfshinë fshatrat Pllajnik, Xerrxe, Rrenc Baqkë, Dikancë, Orqushë, Zlipotok, Krstec, dhe Leshtan.

Neni 8

8.1. Vlera e pronave përcaktohet sipas zonave të vlerësimit dhe janë të shprehura në € për 1 m² si vijon:

Zona e parë I-rë

1.Pronat e domosdoshme për qëllime banimi	
a/shtëpitë	250,00
b/banesa	270,00
2.Pronat komerciale	500,00
2a/ Vlera e pronës për terrenet sportive të tipit të hapur përcaktohet në	45,00
2b/ Vlera e pronës për terrenet sportive të tipit të mbyllur përcaktohet në	60,00
3.Pronat industriale	450,00

8.2.Çmimet nga zona e parë aplikohen vetëm për qytezën e Dragashit.

Zona e dytë II-rë

1.Pronat e domosdoshme për qëllime banimi	
a/ shtëpitë	200,00
b/banesa	220,00
2.Pronat komerciale	400,00
3.Pronat industriale	400,00

Zona e tretë III-të

1.Pronat e domosdoshme për qëllime banimi	
a/ shtëpitë	170,00
b/banesa	200,00
2.Pronat komerciale	300,00
3.Pronat industriale	300,00

Neni 9

9.1.Të gjithë personat, të cilët posedojnë ose banojnë në një pronë të paluajtshme janë të obliguar që t'a regjistrojnë atë pronë në bazë të të dhënave për tatimin komunal të pronës dhe t'i ofrojnë komunës informacionin lidhur me pronën e paluajtshme, e cila i nënshtrohet regjistrimit me 1 mars ose para 1 marsit të çdo periudhe tatimore.

9.2 Të gjithë personat ,të cilët posedojnë ,shfrytëzojnë ose marrin një pronë të paluajtshme në shfrytëzim,duhet t'i lejojnë zyrtaret e autorizuar që përfaqësojnë autoritetin komunal të tatimit në pronë ,të hyjnë në tokën dhe në ndërtesat e tyre gjatë orëve të ditës për t'i mbledhur të dhënat lidhur me pronën.

Neni 10

10.1 Funkcionet e komunës sa i përket administrimit të tatimit në pronë janë:

- a/ menaxhimi i informatave tatimore mbi pronën,
- b/ vlerësimi i pronës,
- c/ përgaditja dhe lëshimi i faturave të tatimit
- d/ inkasimi dhe inkasimi i detyruar i tatimit mbi pronën dhe
- e/ankesat administrative.

10.2 Baza e të dhënave mbi pronën bazohet në regjistrin e të drejtave mbi pronën dhe katastrin e tokës.Zyra Katastrale komunale siguron bazën e të dhënave mbi pronën dhe informacionet e nevojshme nga regjistri.

10.3 Komuna e përcjell vlerën e tregut të çdo prone që është nën juridiksionin e sajë.

10.4 Fatura për tatimin në pronë lëshohen nga baza e të dhënave deri më 31 mars ose para 31 marsit të secilit vit.

10.5 Ministria e Financave ,duke shfrytëzua praktikat e viteve të më parshme merr pelqimin e komunës që mund të lidhë marrveshje me PTK-ën për përgatitur,printimin ,zarfimin dhe dërgimin e faturave deri te obliguesi tatimor me çmime të cilat më parë i bëhen te ditura komunës.

10.6 Pagesa e tatimit në pronë bëhet në dy këste të barabarta më 30 qershor dhe me 31 dhjetor.

10.7 Për mos pagesën e tatimit në prone, sipas afateve te pëcaktuara, do të llogariten kamata ndëshkuese në baza mujore.Kamata llogaritet nga data kur duhet të paguhet tatimi deri në daten kur është pagua tatimi.

Neni 11

11.1 Komuna ,duke pas parasysh gjndjen e veshtirë financiare të tatimpaguesit , mund ti lejojë tatimpaguesit që ta shtyej pagimin e tatimit në pronë me kusht që shtyrja të vlejë për një faturë tatimore e cila kufizohet për një afat kohor që nuk tejkalon dy vite.

11.2 Tatimpaguesi që dëshiron shtyrjen e pagesës së tatimit në pronë duhet të paraqes dëshmi të sakta të cilat mbështesin kërkesën e tijë.

Neni 12

12.1 Çdo obligues tatimor ka të drejtë ankese nëse konsideron se nuk është bë vlerësimi i drejtë i pronës së tijë ose ndonji parregullësi tjeter lidhur me pronën në bazën e të dhënave.

12.2 Kërkesa mbi shqyrtimin e faturës mbi pronën i drejtohet Bordit komunal për ankesa .Kjo kërkesë duhet të parashtrohet Bordit për shqyrtim në afatin prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës duke u përcjell me dëshmi mëbështetëse që deshiron të paraqes tatimpaguesi.

12.3 Kërkesa e tatimpaguesit për shqyrtimin e faturës tatimore nuk pezullon obligimin për t'a paguar tatimin.

12.4 Bordi komunal për ankesa Brenda 60 ditësh do të njoftojë parashtruesin e ankeses – tatimpaguesin për vendimin e tijë.

Neni 13

13.1 Çështjet të cilat nuk janë përfshir në këtë Rregullore do të aplikohen nga Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtëshme..

Neni 14.

14.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore ,pushon të jetë në zbatim Rregullorja mbi tatimin në pasurinë e palujtshme ne teritorin e komunës së Dragashit 01 nr.06-1604/2 prej 28.09.2012.


14.2 Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi I komunës , ndërsa do të zbatohet nga 01.01.2014.

Neni 15

15.1 Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim-Njësija për tatim në pronë.

Dragash,26.09.2013
01 Nr.06-1477/2

KRYESUESI I KUVENDIT
Shaban Shabani



New Reply | Search email

Delete | Archive | Junk | Sweep | Move to

Categories

ahmet

Folders

Inbox

Junk 1

Drafts

Sent

Deleted 5

New folder

Quick views

Documents

Flagged

Photos

New category

RE: Konfirmimi i Rregullores mbi tatimin ne pronë



Dashurie Kuqi (DKuqi@mfe-ks.org) Add to conta

To: ahmet bahtijari

Cc: Shkelzen Morina, Agron Thaqi

Përshëndetje,

Draft rregullorja e Tatimit ne Pronë është kontrolluar nga DTP
I MF.

Propozim Rregullorja e Tatimit në Pronë për vitin 2014 është
në perputhje me legjislacionin në fuqi dhe mund te vazhdoni
me procedurat e më tutjeshme të aprovimit të saj.

Ju falenderoj per bashkepunim

Me respekt

Dashurije Kuqi, Shefe e sektorit në DTP-MF

Search
learn
Dashu

Conten